



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0492

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE "Pylla" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shitja e masës Drunore në Gjilan" me numër të prokurimit 651-23-4164-2-6-10, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit, më 03/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e "Pylla" SH.P.K. me nr. 2023/0492, e datës 15/07/2023, vendimi për dhënie i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shitja e masës Drunore në Gjilan", me numër të prokurimit 651-23-4164-2-6-10, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 12.05.2023, Komuna e Gjilanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar ftesën për ofertim për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shitja e masës Drunore në Gjilan" me nr. të prokurimit: 651-23-4164-2-6-10.

Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues për dhënie të kontratës është publikuar me datën 29.06.2023, ku është rekomanduar për kontratë OE "Rabit Latifi B.I. & Company

ZukaCommerce shpk” nga Gjilani.

OE "Pylla " SH.P.K. me datën 03.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 10.07.2023, AK Komuna e Gjilanit me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Pylla" SH.P.K., me datën 15.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0492, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Vlerësimi dhe administrimi i provave

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pabazuar;
- I lejohej AK të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit

Sqarim hyrës

Pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit në ankesë është formuluar si në vijim “Autoriteti Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit të ofertave nuk kanë qenë objektiv gjatë analizës së ofertave (ka rënë në lajthitje) dhe neve si kompani na kanë eliminuar në kundërshtim me LPP dhe e kanë shpërblyer një kompani e cila nuk i ka plotësuar në plotësi kushtet për shitjen e aseteve në këtë rast “Rabit Latifi B.I. & Zuka Commerce ” shpk nga Gjilani e cila edhe pse me çmim ka qenë më e shtrenjtë por si ka plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara në dosjen e tenderit edhe atë e ka mashtuar apo ma mirë me thënë e ka qitë në lajthitje Autoritetin Kontraktues respektivisht Departamentin e prokurimit duke mos treguar se ka borxhe ndaj Komunës së Gjilanit gjegjësisht Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë”.

Sipas këtij pretendimi ankimor për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës “Rabit Latifi B.I. & Zula Commerce” është tenderues i papërgjegjshëm pasi që sipas parashtruesit i njëjti ka borxhe të pashlyera ndaj autoritetit kontraktues dhe për këtë arsye nuk e ka përmbushur nënkriterin nr. 4 të dosjes së tenderit.

Përgjigja në pretendimin ankimor

Fillimisht duhet cekur se nënkriteri nr. 4 në dosjen e tenderit është përcaktuar si në vijim: “Vërtetim nga Autoriteti Pyjor Komunal (kopje)“, ndërsa dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë nënkriter është “Vërtetim nga Autoriteti Pyjor Komunal se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur procedurë për dëme pyjore edhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontratat e më parme”.

Me qëllim që të plotësohet ky nënkriter i dosjes së tenderit, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe Vërtetimin me nr. prot. 09-320/01-0047745/23 i datës 19.05.2023 nga Sektori i Pylltarisë në Komunën e Gjilanit për operatorin ekonomik N.T.P. “Blini & Cati” (“Rabit Latifi” B.I.).

Nga gjendja faktike e konstatuar si më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur në tërësi nënkriterin nr. 4 të dosjes së tenderit të cituar si më sipër. Kjo nënkupton që i njëjti nuk ka borxhe të pashlyera ndaj autoritetit kontraktues për të cilat do të mund të shpallej si i papërgjegjshëm në raport me aktivitetin përkatës të prokurimit. Për këto arsye eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

REKOMANDIMET

Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar si dhe të vërtetohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se pretendimet ankimore nuk janë të trajtuara drejtë me prova dhe me fakte nga ana e ekspertit shqyrtues dhe si të tilla nuk mund të pranohen nga paneli shqyrtues.

Ankues (cituar si më sipër) ka atakuar vendimin e autoritetit kontraktues sa i përket shpalljes së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se është i papërgjegjshëm ngase nuk ka plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara në dosjen e tenderit edhe atë e ka mashtruar apo ma mirë me thënë e ka qitë në lajthitje Autoritetin Kontraktues respektivisht Departamentin e prokurimit duke mos treguar se ka borxhe ndaj Komunës së Gjilanit gjegjësisht Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, si dhe duke prezentuar në ankesën e tij dëshmi Vërtetimin me nr. prot. 09-320/01-0063091/23 i datës 03.07.2023 nga Sektori i Pylltarisë në Komunën e Gjilanit për operatorin ekonomik N.T.P. “Blini & Cati” (“Rabit Latifi” B.I.), që ka dësnim për kundërvajtje dhe nuk ka shlyer obligimet e dënimit ndaj Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari. Ndërsa, lidhur me këtë eksperti shqyrtues konstaton se "me qëllim që të plotësohet ky nënkriter i dosjes së tenderit, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe Vërtetimin me nr. prot. 09-320/01-0047745/23 i datës 19.05.2023 nga Sektori i Pylltarisë në Komunën e Gjilanit për operatorin ekonomik N.T.P. “Blini & Cati” (“Rabit Latifi” B.I.). Nga gjendja faktike e konstatuar si më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur në tërësi nënkriterin nr. 4 të

dosjes së tenderit të cituar si më sipër. Kjo nënkupton që i njëjti nuk ka borxhe të pashlyera ndaj autoritetit kontraktues për të cilat do të mund të shpallej si i papërgjegjshëm në raport me aktivitetin përkatës të prokurimit. Për këto arsye ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar në tërësi. Paneli shqyrtues nuk e mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues për faktin se ekspertit shqyrtues nuk ka bërë vlerësim real as të gjendjes faktike e as të gjendjes juridike, së paku ka qenë dashtë të kërkoj informacione shtesë nga Drejtoria në fjalë lidhur me këto vërtetime, me qëllim që me ardh deri te një konstatim i saktë. Andaj, paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e kthen në ri-vlerësim për faktin se janë paraqitur dy dokumente të lëshuara nga drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Gjilanit dhe Sektori i pylltarisë në Komunën e Gjilanit të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe për një konstatim të saktë të kësaj gjendje obligohet AK Komuna e Gjilanit të bëjë verifikimin e këtyre dy dokumenteve dhe konstatimit të saktë sa i përket shlyerjes së obligimeve dhe pastaj të filloj fazën e ri-vlerësimit konform kërkesave të paraqitura në Dosjen e Tenderit sipas nenit 59 të LPP.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - " Pylla " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: